

On the translation of EU legislation in Albanian and the creation of the pertaining terminology

Abstract: *Albania has already entered the final stage of the European integration process, that is, membership negotiations. This phase is expected to be long and difficult, requiring considerable resources and capacities to align all national standards with European ones. In addition to the work of institutions for the adaptation of community legislation (Acquis Communautaire), a large cost is expected to come from the volume of translation required. It is the obligation of each candidate country, aiming for membership, to translate all Community legislation into their own language, as well as national legislation into one of the main languages of the European Union. This process is as complicated and difficult as it is tantalising. In fact, experience has shown that it can complicate institutional affairs even after acquisition of membership.*

The EU itself has paid great attention to the process of translation, both of its corpus of documents into the languages of particular countries, and vice versa. It is fundamental that language concepts have the same semantic value everywhere, for the implementation of the same legal acts in all countries and in all languages of the European Union.

Presently, analysing some of the translated documents, we have noticed problems relating to the lack of standardization of terminology; lack of application of grammar and spelling rules of Albanian, leading to numerous inconsistencies in translations.

Keywords: *European integration process, Acquis Communautaire, terminology, translation, standardization.*

Reflektimin mbi gjuhën dhe aftësinë e saj për të paraqitur sa më saktë realitetin e gjejmë që në antikitet, prej nga na përcillet dija e ku interesi për gjuhën nis pikërisht nga shtypa e arsytetimeve në suazën e filozofisë. Një nga pasazhet që ka ngjallur më shumë interes në këtë këndvështrim është dialogu i Cratylus-it me Hermogen-in. Sokratit i intereson debati mbi marrëdhënien e gjuhës me botën. E, në fakt, Cratylusi dhe Hermogeni

kërkojnë përgjigje nga Sokrati, i cili i qëndron mendimit se gjuha është filozofikisht inferiore ndaj studimit të gjithçkaje që njohim dhe, po ashtu, për të arritur dijen nuk janë më të rëndësishme fjalët, por konceptet që ato shënojnë. Fjalët duhet të shprehin idetë dhe jo idetë të vijnë nga fjalët. Reflektimi filozofik mbi gjuhën sillet rreth pyetjes: a përfaqëson gjuha me besnikëri realitetin apo e deformon atë? E këtui i kthehemi sërish pyetjes së hershme të Ciceronit kur më së pari përkthen ligjëratat e Dimostenit dhe të Eskinit dhe ngre një çështje themelore teorike të parimeve epistemologjike dhe praktikës së përkthimit: nëse përkthyesi duhet t'i jetë besnik fjalëve apo mendimit që përcjell teksti. Zgjidhja që propozon Cicero tashmë përbën një kriter parësor: “Unë i përgatita duke u sjellë jo si përkthyes i thjeshtë [*ut interpretes*], por si shkrimtar [*sed ut orator*], duke respektuar strukturën e fjalive, me figura fjalësh apo mendimesh, duke përdorur, gjithsesi, terma të përshtatshëm me praktikën tona latine. Kështu, nuk e kam konsideruar të nevojshme të përkthej çdo fjalë me një fjalë [*verbo verbum reddere*]; e megjithatë kam ruajtur të paprekur kuptimin thelbësor dhe vlerën e të gjitha fjalëve. [...] Sepse në të vërtetë lexuesit duhet t'i interesojë – sipas meje – që t'i ofrohet, nga këto fjalë, jo numri i fjalëve, por pesha e tyre.”¹

E kështu mendimi mbi marrëdhënien e gjuhës me botën ka ecur karahas zhvillimit të teorisë mbi gjuhën, ndonëse thelbi i shqetësimit antik mbetet i njëjtë edhe në studimet gjuhësore moderne. Teori gjuhësore tashmë të njohura kanë hedhur dritë mbi rëndësinë që ka formimi gjuhësor në perceptimin dhe paraqitjen e realitetit nga njeriu. Herder-i fliste për ndërvlerësinë mes ligjërimit dhe mendimit, nga ana tjetër Humboldt-i, mes gjuhësisë dhe psikologjisë, i afrohej më shumë determinizmit gjuhësor, për të arritur tek ajo që njihet si hipoteza e Sapir – Whorf-it, e cila ndërthur determinizmin gjuhësor (ligjërimi përcakton mendimin) me relativizmin gjuhësor (diversiteti strukturor i gjuhëve është i pakufishëm).

“Human beings do not live in the objective world alone, nor alone in the world of social activity as ordinarily understood, but are very much at the mercy of the particular language which has become the medium of expression for their society. It is quite an illusion to imagine that one adjusts to reality essentially without the use of language and that language is merely an incidental means of solving specific problems of communication or reflection. The fact of the matter is that the “real world is to a large extent unconsciously built up on the language habits of the group... We see and hear and otherwise experience very largely as we do because the language habits of our community predispose certain choices of interpretation.”²

1 Cituar sipas: Mounin, Georges (2006) *Teoria e storia della traduzione*, Einaudi Editore, Torino, Itali, f. 31.

2 Cituar sipas: Carroll, John B. (1956) *Language, thought, and reality - Selected writings of Benjamin Lee Whorf*, The Technology Press of Massachusetts Institute of Technology

Në dekadat e para të shek. XX, Eduard Sapir dhe Benjamin Whorf shkaktuan jo pak debate me propozimin e teorisë që u quajt hipoteza e Sapir – Whorf-it “determinizmi gjuhësor dhe relativizmi gjuhësor.” Ata tërhoqën vëmendjen mbi ndikimin që ka gjuha në formimin e mendësisë së atyre që e flasin, si edhe ndaj dallimeve në mënyrën e të shprehurit mbi botën dhe format e ndryshme, sipas të cilave struktura e një gjuhe strukturon perceptimin dhe paraqitjen e realitetit.

Në këtë dritë, leksiku i një gjuhe paraqet tërësinë e dijes që zotëron një shoqëri. Prania apo mungesa e fjalëve ose termave lidhet me interesin që ato paraqesin për folësit e kësaj gjuhe, dukuritë, objektet apo konceptet që ata emërtojnë. Nëse nuk janë të rëndësishme për mentalitetin dhe identitetin kulturor të një populli, atëherë një term i vetëm mund të shërbejë për të përfaqësuar një fushë të gjerë leksikore. Nga ana tjetër, nëse perceptohen si të rëndësishme, atëherë do të gjejmë në gjuhë terma specifike për elemente apo shfaqje të veçanta të një dukurie. Ndryshimet që mund të ndodhin në një shoqëri mund të jenë të mëdha e mund të vijnë në një kohë të shkurtër, por krijimi i koncepteve të reja është i lidhur me mendësinë dhe krijimi i termave për t’i paraqitur ato në një gjuhë të dhënë kërkon edhe më shumë kohë, veçanërisht kur bëhet fjalë për ndryshime të sistemit kulturor, ligjor apo politik.

“... prirja për ndryshim të shpejtë gjuhësor me një kompleksitet gjithnjë e më të shpejtë të kulturës mund të kontrollohet nga një nga elementet më të rëndësishme të vetë një kulture të përparuar, domethënë përdorimi i një grupi dytësor simbolesh gjuhësore që domosdoshmërisht përmbajnë konservatorizëm më të madh se grupi i simboleve të përdorura dhe duke ushtruar një ndikim ruajtës në këtë të fundit. [...] mbase paradoksi i dukshëm në të cilin kemi arritur përmban një element liberal të së vërtetës. Unë nuk jam i prirur ta konsideroj rastësi që zhvillimi i shpejtë i kulturës në Evropën Perëndimore, gjatë 2000 viteve të fundit, ka qenë sinkron me atë që duket të jenë ndryshime jashtëzakonisht të shpejta në gjuhë...”³

Me zhvillimet e Bashkimit Evropian dhe proceset integruese, vendet që synojnë anëtarësimin kalojnë në një proces transformimi kulturor, i cili shoqërohet me krijimin e koncepteve të reja kulturore e juridike dhe, si pasojë, të krijimit të një sërë termash të rinj apo huazimesh të shumta, kur mungon puna e organizuar e gjuhëtarëve për plotësimin me njësi të reja. E, në këtë mënyrë, shoqëria bashkëkohore vijon në atë rrugën e përballjes së ndërkombëtarizimit dhe qasjeve nacionaliste, që në këtë rast janë sa të nevojshme aq edhe të vështira për t’u zhvilluar mbi baza shkencore, pa bashkëpunimin e gjuhëtarëve e nisma institucionale.

and John Wiley & Sons, Inc. New York, London.

- 3 Mandelbaum, G. (1963) *Selected Writing's of Edward Sapir in Language, Culture and Personality*, Berkeley and Los Angeles- University of California Press, f. 91-103.

“Pavarësisht nga dallimet midis pikëpamjeve kanonike mbi shfaqjen e kombësisë në Evropë, pikat e mëposhtme kanë ndikim në historinë bashkëkohore. Shteti kombëtar, d.m.th një shtet sovran në të cilin mbizotëron një popull (i perceptuar si) mjaft homogjen në aspektin etnik dhe/ose kulturor, është një krijim i Evropës Perëndimore që filloi të përhapet pas Revolucionit Francez në 1789 – fillimisht në Evropë dhe më pas, për shkak të kolonializmit. Kombi dhe degët e tij (kombësitë, gjuhët kombëtare) janë kështu ndërtime të drejtuara nga shteti. Është siç shprehet Eric Hobsbawm (1990): nacionalizmi ndjek shtetin dhe jo anasjelltas; kombet (dhe gjuhët kombëtare) mund të njihen vetëm a posteriori.

Në një përpjekje për të krijuar unitet, jo më pak për qëllime luftarake, shtetet kërkuar në mënyrë aktive të homogjenizojnë gjuhët e tyre popullore dhe praktikën kulturore të kryera në territoret e tyre. ‘Në krijimin e Evropës moderne’, na kujton Peter A. Kraus, ‘norma cuius regio, eius religio’ shpesh gjente vazhdimin e saj ‘natyror’ në politikën e ‘cuius regio, eius lingua’ ”⁴.

Vetë BE i ka dhënë një rëndësi të madhe procesit të përkthimit, si të korpusit të dokumenteve të veta në gjuhët e vendeve të veçanta, ashtu edhe anasjelltas. Është themelore që konceptet gjuhësore të kenë të njëjtën vlerë semantike kudo, për zbatimin e të njëjtave akte ligjore në të gjitha shtetet dhe në të gjitha gjuhët e Bashkimit Evropian. Për këtë ekziston edhe IATE, baza e të dhënave e terminologjisë ndër-institucionale e BE-së. IATE administrohet nga një grup me përfaqësues nga institucionet më të rëndësishme të BE-së. Po kështu, Parlamenti Evropian ka një infrastrukturë të pasur e të mirëorganizuar dedikuar përkthimit dhe gjithë punës së nevojshme kërkimore mbi krijimin dhe harmonizimin e terminologjisë së përkthimit të akteve të BE-së. Kjo nismë në fushën e përkthimit të specializuar përbën projektin më të rëndësishëm të përkthimit, që përfshin një volum pune prej qindra mijëra faqesh dhe krijimin e një fjalori të tërë termash të fushës, veçanërisht në vende me një demokraci të re dhe kulturë të re ligjore, si yni. Mungesa e një pune të tillë nuk sjell vetëm tekste të përkthyer keq, por mund ta shpjerë në të ardhmen shtetin në barrën e aulave të gjyqeve ndërkombëtare, për shkak të moszbatueshmërisë rigorozë të normave ligjore, nisur nga pasaktësia e koncepteve të përkthyer në gjuhën e vendit. Kjo nuk është thjesht një hipotezë teorike kasandrike, por një realitet që ndodh edhe në vende tashmë anëtare të BE-së, por që nuk e kanë trajtuar si duhet çështjen e përkthimit të korpusit të akteve ligjore.

“Hibriditeti është i dukshëm jo vetëm në nivelin konceptual të strukturave të përbashkëta mendore, por edhe në nivelin gramatikor dhe stilistik. Kultura juridike e BE-së dhe faktorë të ndryshëm kontekstualë çojnë në shfaqjen e varianteve të dallueshme të gjuhëve juridike të ‘evropianizuara’

4 Leal, Alice [2021] *English and Translation in the European Union*, Routledge, f. 11.

- eurolektet. Shumica e studiuesve pajtohen se tekstet e BE-së, të cilat karakterizohen nga 'dukshmëria ekstreme' e 'përkthyeshmërisë' së teksteve" [...], kanë zhvilluar një gjuhë ose stil specifik që largohet nga disa konventa të gjuhëve kombëtare [...], të standardizuara për të pasqyruar zërin e BE-së [...]. Dallimet duket se janë mjaft të mëdha për të mundësuar perceptimin e gjuhës së BE-së si një variant i ri ligjor i gjuhëve zyrtare që shfaqet përmes përkthimit [...].

Për ta përmbledhur, ndërvarësitë dhe tensionet e ndërsjella midis mbikombëtares dhe kombëtares krijojnë një hapësirë konceptuale dhe gjuhësore hibride brenda së cilës kultura juridike e BE-së ka evoluar përmes përkthimit shumëgjuhësh."⁵

Vetë gjuha standarde është e pamjaftueshme për të ofruar bazën e të dhënave terminologjike për gjuhën ligjore që parashikon përkthimi i gjithë korpusit të ligjeve të BE-së. Standardizimi i terminologjisë ka shumë rëndësi, pasi qartësia e koncepteve ligjore të shprehura përmes termave të dhënë, do të shërbejë edhe për përkthimin e legjislacionit tonë në gjuhët e BE-së. Është detyrim për vendin tonë, me hapjen tashmë të negociatave për anëtarësimin në BE, që, krahas punës për përmbushjen e kriterëve ligjore, politike, ekonomike etj., duhet të përkthehen në shqip *acquis communautaire*, çka presupozon krijimin e një gjuhe dhe kulture të re ligjore në gjuhën tonë, ku përkthimi ka një rol shumë të rëndësishëm.

"Ngjashmëritë janë gjithashtu të dukshme në të drejtën penale ku ligjet në të katër vendet⁶ i kuptojnë nocionet e *mens rea* dhe neglizhencës në të njëjtën mënyrë, ndryshengashumëjuridiksionetë tjera që kanë interpretime më kufizuese ose përkufizime më pak të sakta të këtyre koncepteve. Për këtë qëllim, ato ligje përmbajnë të njëjtat formulime juridike të këtyre dy nocioneve. *Mens rea* kuptohet si synimi për të shkaktuar pasojat e ndaluara kur një person është i vetëdijshëm se rezultati do të ndodhë dhe dëshiron që ai të ndodhë ose kur një person është i vetëdijshëm se mund të kryejë aktin e ndaluar dhe jep pëlqimin për kryerjen e tij. Neglizhenca gjithashtu merr dy forma, duke përfshirë kur një person është i vetëdijshëm se veprimi i tij mund të rezultojë në aktin e ndaluar, por ai/ajo në mënyrë të paarsyeshme arrin në përfundimin se nuk do të ndodhë, ose se ai/ajo do të jetë në gjendje ta parandalojë atë ose kur një person nuk mendon fare për mundësinë që veprimi i tij të rezultojë në rezultatin e ndaluar edhe pse një person i arsyeshëm duhet ta njohë këtë rrezik."⁷

5 Vilelmini Sosoni, Łucja Biel (2018) "EU Legal Culture and Translation", International Journal of Language & Law, Sosoni & Biel, JLL 7, Vol. 7, f. 4.

6 Autorja i referohet Serbisë, Kroacisë, Bosnje-Hercegovinës dhe Malit të Zi.

7 Aleksandra Čavoški, *Legal Language and EU Integration — The Case of the Western Balkans* (2018) International Journal of Language & Law, Sosoni & Biel, JLL 7, Vol. 7, f. 82-83. (file:///C:/Users/User/Downloads/hhamann,+20180625_5-Cavoski.pdf).

Ne jemi dy vende në Ballkanin Perëndimor që kemi të njëjtën gjuhë standarde, ndaj edhe mund të bashkojmë burimet njerëzore për një punë të përbashkët mes Shqipërisë dhe Kosovës, që do të shërbente për një harmonizim më të mirë të terminologjisë juridike dhe që përbën një strategji pune që mbështetet edhe nga Komisioni Evropian e që po e shohim në rastin e Kroacisë, e cila i vuri në dispozicion Serbisë, Malit të Zi dhe Bosnie-Hercegovinës gjithë korpusin e teksteve të përkthyer. Me këtë mendësi u punua kur vendet e Ballkanit Perëndimor u mbështetën për një projekt të përbashkët, për krijimin e bazës së të dhënave terminologjike, në kuadër të procesit të integritit evropian. Krijimi i kësaj baze të dhënash u bë në kuadër të projektit që për vendin tonë ishte “Mbështetje për Ministrinë Shqiptare të Integritit Evropian” (SMEI II). Ky projekt⁸ financohej nga Bashkimi Evropian (IPA 2008) dhe Qeveria e Republikës Federale të Gjermanisë (BMZ) dhe zbatohet nga Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit (GIZ) GmbH. Përditësimi i saj mbetet i domosdoshëm, ndonëse duket se është lënë jashtë vëmendjes.

“Komisioni siguron fonde për ngritjen e sistemeve kombëtare për përkthime. Për këtë qëllim, Komisioni financoi një projekt pilot në Serbi për të përkthyer 16,000 faqe të *acquis* të BE-së në serbisht, të cilat janë të aksesueshme për përkthyesit në vendet e tjera të Ballkanit Perëndimor. Në këtë mënyrë, Komisioni nxit teknokratët e vendeve që të përfitojnë nga gjuha e ngjashme ligjore.”⁹

Serbia, Bosnie-Hercegovina dhe Mali i Zi jo vetëm shfrytëzojnë produktin e procesit të përkthimit nga Kroacia, por edhe bashkëpunojnë për harmonizimin e terminologjisë. Kështu, siç vë në dukje Čavoški (2018:89) “*acquis communautaire*” është përkthyer, së pari, nga Kroacia “pravna tekovina ose pravna stečevina” dhe është përdorur në vijim njësoj edhe nga të tria vendet e tjera.

Po ashtu, sjell përsëri në vëmendje Čavoški (2018:91), ky nuk është vetëm rasti kur teknokratët kombëtarë përballen me konstrukte dhe terma të rinj ligjorë. Çuditërisht, kjo prirje shfaqet edhe për termat që tashmë janë krijuar brenda sistemeve ligjore kombëtare dhe janë pjesë e legjislacionit ekzistues të kulturës. Këto konstrukte dhe terma shpesh përshkruhen në direktivat e BE-së që i largohen diskrecionit të shteteve anëtare për të zbatuar normat e BE-së, edhe pse në disa raste ky diskrecion mund të jetë mjaft i kufizuar. Një shembull ilustrues është Direktiva për mbetjet/waste (2008/98/EC), e cila përcakton konceptin e mbetjeve dhe prezanton disa koncepte të reja. Ky përkufizim i ri prezanton termin hedh/

8 <http://www.albterm.net/>

9 Aleksandra Čavoški, *Legal Language and EU Integration — The Case of the Western Balkans* (2018) *International Journal of Language & Law*, Sosoni & Biel, JLL 7, Vol. 7, f. 87 (file:///C:/Users/User/Downloads/hhamann,+20180625_5-Cavoski.pdf).

discard, i cili është thelbësor për të kuptuar termin mbetje pasi mbetjet sipas përkufizimit hidhen.¹⁰

Ne kemi analizuar disa dokumente të përkthyer në gjuhën shqipe, si edhe Marrëveshjet e Stabilizim Asociimit të Shqipërisë dhe të Kosovës. Nga krahasimi i këtyre dy dokumenteve vërehet se nuk ka asnjë koordinim mes dy vendeve për harmonizimin dhe standardizimin e terminologjisë së BE-së, ndërkohë që kjo është një çështje shumë e rëndësishme.

- Shqetësimi i parë që lind, lidhet me përkthimin fjalë për fjalë pa ia përshtatur aspak shqipes, as në strukturë fjalie, as në terminologji.

Mund të shohim më poshtë disa raste nga dekretet e përkthyer.

- *In particular, there is a need to rethink the arrangements for applying **the exception from the prohibition on agreements**, which restrict competition, laid down ...*¹¹

*Në veçanti, është e nevojshme të rimendohen rregullimet ligjore **mbi zbatimin e përjashtimit nga ndalimi i marrëveshjeve**, të cilat kufizojnë konkurrencën, të përcaktuara ...*¹²

- *In order to **ensure** that the Community competition rules are applied effectively*¹³

*Me qëllim që **të sigurojnë** se rregullat e konkurrencës të Komunitetit zbatohen në mënyrë efektive*¹⁴

- *In order to create a **level playing field** for agreements...*¹⁵

*Me qëllim që të krijohet **një nivel fushe loje** për marrëveshjet*¹⁶...

10 The Montenegrin and Serbian definitions of waste are identical in defining the key term discard, though there is a slight difference in defining the holder of the waste. However, this does not affect the main understanding of the term discard which remains the same between the two language versions. The only difference with the Bosnian version is that the Serbian and Montenegrin statutes use the term that means discard while the Bosnian version uses the term dispose, which was used in French and German texts of the Directive on waste (European Commission, 2010). Equally, the same legal terms are used for concepts such as operator, polluter-pays and household waste, which are new to the legal system in Western Balkan countries. (f. 92).

11 COUNCIL REGULATION (EC) No 1/2003 of 16 December 2002 on the implementation of the rules on competition laid down in Articles 81 and 82 of the Treaty.

12 Rregullorja e Këshillit (KE) nr. 1/2003 e 16 dhjetorit 2002 mbi zbatimin e rregullave mbi konkurrencën, të përcaktuara në nenet 81 dhe 82 të traktatit (tekst kuptimi i të cilit lidhet me ZEE).

13 COUNCIL REGULATION (EC) No 1/2003 of 16 December 2002 on the implementation of the rules on competition laid down in Articles 81 and 82 of the Treaty.

14 Rregullorja e Këshillit (KE) nr. 1/2003 e 16 dhjetorit 2002 mbi zbatimin e rregullave mbi konkurrencën, të përcaktuara në nenet 81 dhe 82 të traktatit (tekst kuptimi i të cilit lidhet me ZEE).

15 COUNCIL REGULATION (EC) No 1/2003 of 16 December 2002 on the implementation of the rules on competition laid down in Articles 81 and 82 of the Treaty.

16 Rregullorja e Këshillit (KE) nr. 1/2003 e 16 dhjetorit 2002 mbi zbatimin e rregullave

- *The Commission **should be empowered** ...*¹⁷
*Komisioni **duhet të jetë i autorizuar**...*¹⁸
- *It is desirable to grant some degree of **flexibility** to infrastructure managers to enable a more efficient use to be made of the infrastructure network.*¹⁹
*Për të mundësuar një përdorim më efikas të rrjetit infrastrukturor parapëlqehet që administruesit e infrastrukturës të gëzojnë një shkallë të caktuar **lakueshmërie**.*²⁰
- *Any charging scheme will send economic signals to users. It is important that those signals to railway undertakings should be consistent and lead them to make rational decisions.*²¹
*Çdo skemë e tarifimit i jep përdoruesve sinjale ekonomike. Është e rëndësishme që sinjalet ndaj ndërmarrjeve hekurudhore të jenë të qëndrueshme të arsyeshme.*²²
- ***In order to obtain** the safety certificate... The railway undertaking shall also prove that the rolling stock **making up the trains** has been approved by the public authority*²³
***Me qëllim marrjen** e certifikatës së sigurisë ... Ndërmarrja hekurudhore provon, gjithashtu, që **mjetet e transportit hekurudhor që formojnë trenat** të jenë miratuar nga autoriteti publik*²⁴

mbi konkurrencën, të përcaktuara në nenet 81 dhe 82 të traktatit (tekst kuptimi i të cilit lidhet me ZEE).

- 17 COUNCIL REGULATION (EC) No 1/2003 of 16 December 2002 on the implementation of the rules on competition laid down in Articles 81 and 82 of the Treaty.
- 18 Rregullorja e Këshillit (KE) nr. 1/2003 e 16 dhjetorit 2002 mbi zbatimin e rregullave mbi konkurrencën, të përcaktuara në nenet 81 dhe 82 të traktatit (tekst kuptimi i të cilit lidhet me ZEE).
- 19 DIRECTIVE 2001/14/EC OF THE EUROPEAN PARLIAMENT AND OF THE COUNCIL of 26 February 2001 on the allocation of railway infrastructure capacity and the levying of charges for the use of railway infrastructure and safety certification.
- 20 Direktiva 2001/14/KE e Parlamentit Europian dhe e Këshillit e 26 shkurtit 2001, për ndarjen e kapaciteteve të infrastrukturës hekurudhore dhe caktimin e tarifave për përdorimin e infrastrukturës hekurudhore, dhe certifikimin e sigurisë.
- 21 DIRECTIVE 2001/14/EC OF THE EUROPEAN PARLIAMENT AND OF THE COUNCIL of 26 February 2001 on the allocation of railway infrastructure capacity and the levying of charges for the use of railway infrastructure and safety certification.
- 22 Direktiva 2001/14/KE e Parlamentit Europian dhe e Këshillit e 26 shkurtit 2001, për ndarjen e kapaciteteve të infrastrukturës hekurudhore dhe caktimin e tarifave për përdorimin e infrastrukturës hekurudhore, dhe certifikimin e sigurisë.
- 23 DIRECTIVE 2001/14/EC OF THE EUROPEAN PARLIAMENT AND OF THE COUNCIL of 26 February 2001 on the allocation of railway infrastructure capacity and the levying of charges for the use of railway infrastructure and safety certification.
- 24 Direktiva 2001/14/KE e Parlamentit Europian dhe e Këshillit e 26 shkurtit 2001, për ndarjen e kapaciteteve të infrastrukturës hekurudhore dhe caktimin e tarifave për përdorimin e infrastrukturës hekurudhore, dhe certifikimin e sigurisë.

- *Transfers subject to **appropriate safeguards***²⁵
*Transferimet i **nënshtrohen mbrojtjes së përshtatshme***²⁶
- *In its control of the **proportionality** of the coercive measures*²⁷
*Në kontrollin e **tij të përpjesëtimit** me masat detyruese*²⁸
- *in order to: (a) avoid obstructing official or legal inquiries, investigations or procedures*²⁹
*me qëllim **që të: (a) mos pengesat** pengojnë kërkesat, hetimet apo procedurat zyrtare apo ligjore.*³⁰

Mund të rendisim shembuj të shumtë për të treguar se përkthimi i këtyre dokumenteve nuk respekton aspak strukturën e mendimit në gjuhën shqipe, pra, nuk realizon si duhet as parimet themelore të punës së një përkthyesi. Shpesh teksti përcjell jo vetëm paqartësi kuptimore, madje ndodh të jetë e vështirë ta kuptosh pa iu referuar origjinalit. Duke u ndalur shkurtimisht në shembujt e mësipërm, do të shënonim se do të ishte e vështirë për t'u kuptuar dhe e pamundur që një shqiptar të ndërtojë struktura të tilla si: *nënshtrohen mbrojtjes së përshtatshme (po mbrojtja e papërshtatshme çfarë është?), me qëllim marrjen e..., mjetet e transportit hekurudhor që formojnë trenat etj.*

- 25 DIRECTIVE (EU) 2016/680 OF THE EUROPEAN PARLIAMENT AND OF THE COUNCIL of 27 April 2016 on the protection of natural persons with regard to the processing of personal data by competent authorities for the purposes of the prevention, investigation, detection or prosecution of criminal offences or the execution of criminal penalties, and on the free movement of such data, and repealing Council Framework Decision 2008/977/JHA.
- 26 DIREKTIVA (BE) 2016/680 E PARLAMENTIT EVROPIAN DHE E KËSHILLIT e 27 prillit 2016 për mbrojtjen e personave fizikë në lidhje me përpunimin e të dhënave personale nga autoritetet kompetente me qëllim parandalimin, hetimin, zbulimin, ndjekjen penale të veprave penale apo ekzekutimin e dënimeve penale dhe për lëvizjen e lirë të këtyre të dhënave dhe shfuqizimin e Vendimit Kuadër të Këshillit 2008/977/JHA.
- 27 COUNCIL REGULATION (EC) No 1/2003 of 16 December 2002 on the implementation of the rules on competition laid down in Articles 81 and 82 of the Treaty.
- 28 Rregullorja e Këshillit (KE) nr. 1/2003 e 16 dhjetorit 2002 mbi zbatimin e rregullave mbi konkurrencën, të përcaktuara në nenet 81 dhe 82 të traktatit (tekst kuptimi i të cilit lidhet me ZEE).
- 29 DIRECTIVE (EU) 2016/680 OF THE EUROPEAN PARLIAMENT AND OF THE COUNCIL of 27 April 2016 on the protection of natural persons with regard to the processing of personal data by competent authorities for the purposes of the prevention, investigation, detection or prosecution of criminal offences or the execution of criminal penalties, and on the free movement of such data, and repealing Council Framework Decision 2008/977/JHA.
- 30 DIREKTIVA (BE) 2016/680 E PARLAMENTIT EVROPIAN DHE E KËSHILLIT e 27 prillit 2016 për mbrojtjen e personave fizikë në lidhje me përpunimin e të dhënave ersonale nga autoritetet kompetente me qëllim parandalimin, hetimin, zbulimin, ndjekjen penale të veprave penale apo ekzekutimin e dënimeve penale dhe për lëvizjen e lirë të këtyre të dhënave dhe shfuqizimin e Vendimit Kuadër të Këshillit 2008/977/JHA.

- Po ashtu ndodh edhe me shembuj ku kallëzuesi është një kalk i origjinalit në anglisht, *should be empowered* - duhet të jetë i autorizuar dhe nuk formohet në përputhje me rregullat e shqipes duke përdorur formën joveprore të foljes: *duhet të autorizohet*; apo me qëllim që të sigurojnë se rregullat ... zbatohen, në vend të për t'u siguruar që rregullat të zbatohen..
- Një tjetër çështje që na ka tërhequr vëmendje është zbatimi i normës gramatikore, në lidhje lakimin e emrave, nyjës, përshtatjen e gjymtyrëve të dyta me kryesoret, rendin e fjalëve në fjali etj.
 - *hapat procedurale të marra*³¹
*për të realizuar **objektivën** e saj*³²
*të rihapit*³³
*elementë të ndryshëm të rrjetit të infrastrukturës hekurudhore*³⁴
*sipas të drejtës Komunitare*³⁵, *ekzistencën e të drejtës për të kërkuar*³⁶
*për të garantuar kudo një shkallë minimale mbrojtje*³⁷
*këto kufij*³⁸
*objektivave afatgjata*³⁹
*shërbimet që i ofrohen ndërmarrjeve hekurudhore*⁴⁰

31 Rregullorja e Këshillit (KE) nr. 1/2003 e 16 dhjetorit 2002 mbi zbatimin e rregullave mbi konkurrencën, të përcaktuara në nenet 81 dhe 82 të traktatit (tekst kuptimi i të cilit lidhet me ZEE).

32 Rregullorja e Këshillit (KE) nr. 1/2003 e 16 dhjetorit 2002 mbi zbatimin e rregullave mbi konkurrencën, të përcaktuara në nenet 81 dhe 82 të traktatit (tekst kuptimi i të cilit lidhet me ZEE).

33 Rregullorja e Këshillit (KE) nr. 1/2003 e 16 dhjetorit 2002 mbi zbatimin e rregullave mbi konkurrencën, të përcaktuara në nenet 81 dhe 82 të traktatit (tekst kuptimi i të cilit lidhet me ZEE).

34 Direktiva 2001/14/KE e Parlamentit Europian dhe e Këshillit e 26 shkurtit 2001, për ndarjen e kapaciteteve të infrastrukturës hekurudhore dhe caktimin e tarifave për përdorimin e infrastrukturës hekurudhore, dhe certifikimin e sigurisë.

35 Direktiva 2001/14/KE e Parlamentit Europian dhe e Këshillit e 26 shkurtit 2001, për ndarjen e kapaciteteve të infrastrukturës hekurudhore dhe caktimin e tarifave për përdorimin e infrastrukturës hekurudhore, dhe certifikimin e sigurisë.

36 DIREKTIVA (BE) 2016/680 E PARLAMENTIT EVROPIAN DHE E KËSHILLIT e 27 prillit 2016 për mbrojtjen e personave fizikë në lidhje me përpunimin e të dhënave ersonale nga autoritetet kompetente me qëllim parandalimin, hetimin, zbulimin, ndjekjen penale të veprave penale apo ekzekutimin e dënimeve penale dhe për lëvizjen e lirë të këtyre të dhënave dhe shfuqizimin e Vendimit Kuadër të Këshillit 2008/977/JHA.

37 Direktiva 2008/50/KE e Parlamentit Evropian dhe Këshillit e 21 Majit 2008 mbi cilësinë e ajrit dhe për ajër më të pastër për Evropën.

38 Direktiva 2008/50/KE e Parlamentit Evropian dhe Këshillit e 21 Majit 2008 mbi cilësinë e ajrit dhe për ajër më të pastër për Evropën.

39 Direktiva 2008/50/KE e Parlamentit Evropian dhe Këshillit e 21 Majit 2008 mbi cilësinë e ajrit dhe për ajër më të pastër për Evropën.

40 Direktiva 2001/14/KE e Parlamentit Europian dhe e Këshillit e 26 shkurtit 2001, për

Në rastet e mësipërme vërehen emra të gjinisë mashkullore të shoqëruar nga mbiemra apo përmemra në gjininë femërore, mbaresa rasore të pasakta të emrave, folje të zgjedhuara gabim e, po ashtu, emra të gjinisë asnjëse me njëjën e paravendosur, të lakuar gabim.

- Moszbatimi i rregullave të drejtshkrimit dhe të pikësimit shoqëron pothuajse të gjitha dokumentet e shqyrtuara, siç mund të shihet nga disa shembuj në vijim.

- që një shkelje të përfundojë, dhe që ndërmarria⁴¹
- në territorin e një Shteti Anëtar⁴²

- Një nga çështjet më problematike është terminologjia e përdorur në përkthim, së cilës i mungon njësimi dhe standardizimi, kështu që gjejmë raste inkoherece terminologjike, pasi i njëjti term anglisht vjen me gjegjëse të ndryshme në shqipe, përdoren huazime, fjalë të ligjëritimit të përgjithshëm në vend të termit, fjalë që nuk e japin saktësisht kuptimin e termit etj.

- Në të njëjtin dokument, ku në variantin anglisht⁴³ del 8 herë termi *case-law*, në dokumentin e përkthyer shqip⁴⁴ shfaqen 3 variante *the existing **case-law** and administrative practice* - në **çështjen ligjore ekzistuese dhe praktikave administrative** *the existing **case-law** and administrative practice* - **çështja gjyqësore e Gjykatës së Drejtësisë ka pranuar se mund të bëhet.** *the **case-law** of the Court of Justice has acknowledged it may do -* **çështja gjyqësore e Gjykatës së Drejtësisë ka pranuar se mund të bëhet** *in accordance with the **case-law** of the Court of Justice* - në përputhje **me praktikën gjyqësore të Gjykatës së Drejtësisë**
- *which prohibit or sanction **unilateral conduct engaged in by undertakings***⁴⁵

ndarjen e kapaciteteve të infrastrukturës hekurudhore dhe caktimin e tarifave për përdorimin e infrastrukturës hekurudhore, dhe certifikimin e sigurisë.

41 Rregullorja e Këshillit (KE) nr. 1/2003 e 16 dhjetorit 2002 mbi zbatimin e rregullave mbi konkurrencën, të përcaktuara në nenet 81 dhe 82 të traktatit (tekst kuptimi i të cilit lidhet me ZEE).

42 Direktiva 2001/14/KE e Parlamentit Europian dhe e Këshillit e 26 shkurtit 2001, për ndarjen e kapaciteteve të infrastrukturës hekurudhore dhe caktimin e tarifave për përdorimin e infrastrukturës hekurudhore, dhe certifikimin e sigurisë.

43 COUNCIL REGULATION (EC) No 1/2003 of 16 December 2002 on the implementation of the rules on competition laid down in Articles 81 and 82 of the Treaty.

44 Rregullorja e Këshillit (KE) nr. 1/2003 e 16 dhjetorit 2002 mbi zbatimin e rregullave mbi konkurrencën, të përcaktuara në nenet 81 dhe 82 të traktatit (tekst kuptimi i të cilit lidhet me ZEE).

45 COUNCIL REGULATION (EC) No 1/2003 of 16 December 2002 on the implementation of the rules on competition laid down in Articles 81 and 82 of the Treaty.

*të cilat ndalojnë ose sanksionojnë **udhëheqje të njëanshme të ndërmarrja nga ndërmarrja***⁴⁶

- *the law of the transmitting authority foresees sanctions of **a similar kind***⁴⁷

*Ligji i autoritetit transmetues parashikon sanksione të një **situatë të ngjashme***⁴⁸

- *the Commission may **conduct** its inquiry into a particular sector of the economy*⁴⁹

*Komisioni mund të **çojë** hetimin e tij brenda një sektori të veçantë të ekonomisë*⁵⁰

- *An **efficient freight sector**, especially across borders*⁵¹

*Një **sektor efikas i transportit të mallrave me hekurudhë***⁵²

- *In particular for **congested infrastructure***⁵³

- *Në veçanti për **infrastrukturën e ngjeshur***⁵⁴

- *An **infrastructure manager** may specify **in the network statement conditions** whereby it will take account of previous levels of utilisation of **train paths** in determining priorities for the **allocation process**.*⁵⁵

46 Rregullorja e Këshillit (KE) nr. 1/2003 e 16 dhjetorit 2002 mbi zbatimin e rregullave mbi konkurrencën, të përcaktuara në nenet 81 dhe 82 të traktatit (tekst kuptimi i të cilit lidhet me ZEE).

47 COUNCIL REGULATION (EC) No 1/2003 of 16 December 2002 on the implementation of the rules on competition laid down in Articles 81 and 82 of the Treaty.

48 Rregullorja e Këshillit (KE) nr. 1/2003 e 16 dhjetorit 2002 mbi zbatimin e rregullave mbi konkurrencën, të përcaktuara në nenet 81 dhe 82 të traktatit (tekst kuptimi i të cilit lidhet me ZEE).

49 COUNCIL REGULATION (EC) No 1/2003 of 16 December 2002 on the implementation of the rules on competition laid down in Articles 81 and 82 of the Treaty.

50 Rregullorja e Këshillit (KE) nr. 1/2003 e 16 dhjetorit 2002 mbi zbatimin e rregullave mbi konkurrencën, të përcaktuara në nenet 81 dhe 82 të traktatit (tekst kuptimi i të cilit lidhet me ZEE).

51 DIRECTIVE 2001/14/EC OF THE EUROPEAN PARLIAMENT AND OF THE COUNCIL of 26 February 2001 on the allocation of railway infrastructure capacity and the levying of charges for the use of railway infrastructure and safety certification.

52 Direktiva 2001/14/KE e Parlamentit Europian dhe e Këshillit e 26 shkurtit 2001, për ndarjen e kapaciteteve të infrastrukturës hekurudhore dhe caktimin e tarifave për përdorimin e infrastrukturës hekurudhore, dhe certifikimin e sigurisë.

53 DIRECTIVE 2001/14/EC OF THE EUROPEAN PARLIAMENT AND OF THE COUNCIL of 26 February 2001 on the allocation of railway infrastructure capacity and the levying of charges for the use of railway infrastructure and safety certification.

54 Direktiva 2001/14/KE e Parlamentit Europian dhe e Këshillit e 26 shkurtit 2001, për ndarjen e kapaciteteve të infrastrukturës hekurudhore dhe caktimin e tarifave për përdorimin e infrastrukturës hekurudhore, dhe certifikimin e sigurisë.

55 DIRECTIVE 2001/14/EC OF THE EUROPEAN PARLIAMENT AND OF THE COUNCIL of 26 February 2001 on the allocation of railway infrastructure capacity and the levying of charges for the use of railway infrastructure and safety certification.

Një administrues infrastrukture mund të specifikojë në kushtet e deklaratës së rrjetit me anë të së cilës merr parasysh nivelet e mëparshme të shfrytëzimit të rrugëkalimeve në përcaktimin e prioriteteve për procesin e ndarjes.⁵⁶

- *The working timetable shall be established once per calendar year.⁵⁷*
- *Grafiku i lëvizjes së trenave përgatitet një herë në çdo vit kalendarik.⁵⁸*
- *train path. means the infrastructure capacity needed to run a train between two places over a given time-period⁵⁹*
- *“rrugëkalimet” nënkupton kapacitetin infrastrukturor të nevojshëm për të lëvizur një tren ndërmjet dy vendeve gjatë një periudhe kohore të caktuar⁶⁰*
- *sulphur dioxide; Nitrogen dioxide⁶¹*
- *të dyoksidit të sulfurit; Dyoksidi i nitrogjenit⁶²*
- *Statement by the Commission: — further reduce the Member States’ permitted national emissions of key pollutants, — reduce emissions associated with refuelling of petrol cars at service stations,⁶³*
- *Deklaratë nga komisioni: — do të zvogëlojnë më tej çlirimet kombëtare të lejuara në Shtetet Anëtare për ndotës kyç, — do të zvogëlojnë çlirimet lidhur me rimbushjen e makinave me benzinë në pikat e karburantit,⁶⁴*
- *measures to limit transport emissions through traffic planning and management⁶⁵*

56 Direktiva 2001/14/KE e Parlamentit Europian dhe e Këshillit e 26 shkurtit 2001, për ndarjen e kapaciteteve të infrastrukturës hekurudhore dhe caktimin e tarifave për përdorimin e infrastrukturës hekurudhore, dhe certifikimin e sigurisë.

57 DIRECTIVE 2001/14/EC OF THE EUROPEAN PARLIAMENT AND OF THE COUNCIL of 26 February 2001 on the allocation of railway infrastructure capacity and the levying of charges for the use of railway infrastructure and safety certification.

58 Direktiva 2001/14/KE e Parlamentit Europian dhe e Këshillit e 26 shkurtit 2001, për ndarjen e kapaciteteve të infrastrukturës hekurudhore dhe caktimin e tarifave për përdorimin e infrastrukturës hekurudhore, dhe certifikimin e sigurisë.

59 DIRECTIVE 2001/14/EC OF THE EUROPEAN PARLIAMENT AND OF THE COUNCIL of 26 February 2001 on the allocation of railway infrastructure capacity and the levying of charges for the use of railway infrastructure and safety certification.

60 Direktiva 2001/14/KE e Parlamentit Europian dhe e Këshillit e 26 shkurtit 2001, për ndarjen e kapaciteteve të infrastrukturës hekurudhore dhe caktimin e tarifave për përdorimin e infrastrukturës hekurudhore, dhe certifikimin e sigurisë.

61 DIRECTIVE 2008/50/EC OF THE EUROPEAN PARLIAMENT AND OF THE COUNCIL of 21 May 2008 on ambient air quality and cleaner air for Europe.

62 Direktiva 2008/50/KE e Parlamentit Evropian dhe Këshillit e 21 Majit 2008 mbi cilësinë e ajrit dhe për ajër më të pastër për Evropën.

63 DIRECTIVE 2008/50/EC OF THE EUROPEAN PARLIAMENT AND OF THE COUNCIL of 21 May 2008 on ambient air quality and cleaner air for Europe.

64 Direktiva 2008/50/KE e Parlamentit Evropian dhe Këshillit e 21 Majit 2008 mbi cilësinë e ajrit dhe për ajër më të pastër për Evropën.

65 DIRECTIVE 2008/50/EC OF THE EUROPEAN PARLIAMENT AND OF THE COUNCIL of

*masa për të kufizuar çlirimet e transportit nëpërmjet planifikimit dhe menaxhimit të trafikut*⁶⁶

Referuar edhe shembujve të mësipërm, në lidhje me terminologjinë, është shqetësues fakti që mungon standardizimi i terminologjisë. Edhe pse dihet se leksiku terminologjik përfshin fjalët që përdoren vetëm në një fushë të caktuar e që termat, brenda sistemit terminologjik ku përdoren, duhet të jenë të njëkuptimshëm dhe të zhveshur nga kuptimet e figurshme dhe emocionale, një pjesë e mirë e tyre karakterizohen nga inkoherenca: vërehen raste kur në vend të termit gjejmë fjalë nga leksiku bisedor, përdoren terma dhe fjalë me kuptim tjetër, apo atje ku termi ka një traditë përdorimi, ai zëvendësohet me një gjetje të re të pakonsoliduar në shqipe.

Për këtë arsye është e domosdoshme puna e përbashkët e gjuhëtarëve, terminologëve, ekspertëve të fushës ligjore, ekonomike, mjedisore etj. Siç thuhet në udhëzues të miratuar nga institucionet evropiane:

Në punën e përbashkët për terminologjinë, rezultatet më të mira arrihen - veçanërisht sa i takon zhvillimit të gjuhës dhe standardizimit të terminologjisë - kur gjuhëtarët, terminologët dhe ekspertët e fushës punojnë së bashku. Në mënyrë të veçantë, këta ekspertë të fushave të ndryshme duhet të kenë njohuri dhe përvojë për të kontribuar në një detyrë komplekse:

- njohuritë e fushës (njohuri konceptuale);
- njohuri gjuhësore (njohuri të përgjithshme dhe specifike për gjuhën);
- njohuri terminologjike (njohuri rreth metodave të punës që lidhin hendekun midis dy llojeve të njohurive të mësipërme).⁶⁷

Një nga shembujt më të mirë mbetet ai i Kroacisë, e cila edhe pse e ka nisur procesin e standardizimit të gjuhës kroate mjaft vonë, pati një organizim të shkëlqyer në lidhje me krijimin, harmonizimin dhe standardizimin e terminologjisë së Bashkimit Evropian, përmes koordinimit të punës së të gjitha institucioneve të përfshira. Madje edhe me përgatitjen e një manuali për përkthimin e *acquis communautaire*, shoqëruar me krijimin e bazës së të dhënave dhe botimin e fjalorëve të fushës.

Procedura e përkthimit dhe certifikimit të termave zhvillohej siç e përshkruajnë Brač - Maja⁶⁸:

21 May 2008 on ambient air quality and cleaner air for Europe.

66 Direktiva 2008/50/KE e Parlamentit Evropian dhe Këshillit e 21 Majit 2008 mbi cilësinë e ajrit dhe për ajër më të pastër për Evropën”.

67 Infoterm (2005) GUIDELINES FOR TERMINOLOGY POLICIES Formulating and implementing terminology policy in language communities, UNESCO, Paris, f. 13 <https://unesdoc.unesco.org/ark:/48223/pf0000140765> (20.03.2023).

68 Brač, Ivana and Maja Lončar (2012) Terminology Planning for the Croatian National Terminology Database STRUNA, Aguado de Cea et al. (Eds.): Proceedings of the 10th

"A subject field expert enters a term with appropriate data categories – to be more specific, out of 46 available categories, the obligatory fields are: term, definition, and English equivalent. The term is then forwarded to the editor. (2) The editor, usually the project leader, edits the entry and either returns it to the term author for improvement or transfers it to the terminologist. (3) The first terminologist edits all the entered data categories in accordance with terminological principles. (4) A language expert corrects orthographic and grammatical errors and in certain situations suggests alternative proposed terms which s/he considers to be a better fit with either the Croatian word formation principles or more eligible than the existing preferred term based on some other criteria. (5) The second terminology expert checks whether the language editing has changed the meaning of the definition. (6) The editor finally reviews the proposed changes (the database interface having been designed to accept changes very easily) and locks the term. If the editor does not want to accept all changes, the main definition can be adapted. If the editor does not accept the changes at all, the term in question will appear in a different colour in the work interface, making it easy for the terminologist to see that the working definition has not been accepted. The project manager has the final say in locking the term as the terminology and language experts cannot independently decide on a definition's validity. At the end of this process, the editor-in-chief of Struna decides that the new terminology collection can be considered finalized and included into Struna, and it then becomes accessible through the search engine."

Në Shqipëri, për fat keq, mungojnë institucione që kanë si detyrë kujdesin ndaj gjuhës dhe punën për krijimin dhe standardizimin e prurjeve të reja, qofshin këto edhe terminologjike. Vetëm një punë e organizuar kështu do ta shpinte procesin në rrugën e duhur. Përndryshe, kjo do të dëmtonte rrugën e integritetit, por edhe mund të kthehet në kosto për shtetin shqiptar edhe pas hyrjes në BE. Një sfidë tjetër është edhe përkthimi i gjuhës së vendit kandidat në një nga gjuhët e Bashkimit Europian, çka është një tjetër kërkesë e procesit. Këto sfida dhe cilësia e dobët që ka rezultuar në disa raste, kanë sjellë edhe ndërlikime të mëdha të mëpasshme nga ana institucionale dhe e zbatimit të legjislacionit. Mjaft të kujtojmë, për shembull, se në rastin e Polonisë, thuhet se dy dekada pas anëtarësimit, ka procese gjyqësore në Gjykatën Evropiane për konflikte të lindura për shkak të përkthimit dhe zbatimit të gabuar të *acquis*. Tashmë, legjislacioni

Terminology and Knowledge Engineering Conference (TKE 2012), pp.258-269. 19-22 June 2012, Madrid, Spain.

(https://www.researchgate.net/publication/235673484_Terminology_Planning_for_the_Croatian_National_Terminology_Database_STRUNA/link/0fcfd512749b519436000000/download. 5.05.2023).

i BE-së ka kaluar 300.000 faqe, kështu që është edhe më e ngutshme dhe e dosmodoshme puna e organizuar institucionale, harmonizimi dhe standardizimi i terminologjisë, krijimi i bazës së të dhënave, si edhe certifikimi i dokumenteve të përkthyer nga ekspertë të fushës.

LITERATURË DHE BURIME TË VJELA

- Mounin, Georges (2006) *Teoria e storia della traduzione*, Einaudi Editore, Torino, Itali
- Carroll, John B. (1956) *Language, thought, and reality - Selected writings* of Benjamin Lee Whorf, The Technology Press of Massachusetts Institute of Technology and John Wiley & Sons, Inc. New York, London
- Mandelbaum, G. (1963) *Selected Writing's of Edward Sapir in Language, Culture and Personality*, Berkeley and Los Angeles- University of California Press
- Leal, Alice [2021] *English and Translation in the European Union*, Routledge
- Vilelmini Sosoni, Łucja Biel (2018) "EU Legal Culture and Translation", *International Journal of Language & Law*, Sosoni & Biel, JLL 7, Vol. 7
- Čavoški, Aleksandra, *Legal Language and EU Integration — The Case of the Western Balkans* (2018) *International Journal of Language & Law*, Sosoni & Biel, JLL 7, Vol. 7, (file:///C:/Users/User/Downloads/hhamann,+20180625_5-Cavoski.pdf)
- Infoterm (2005) *GUIDELINES FOR TERMINOLOGY POLICIES* Formulating and implementing terminology policy in language communities, UNESCO, Paris, f. 13 <https://unesdoc.unesco.org/ark:/48223/pf0000140765> (20.03.2023)
- Brač, Ivana and Maja Lončar (2012) *Terminology Planning for the Croatian National Terminology Database STRUNA*, Aguado de Cea et al. (Eds.): *Proceedings of the 10th Terminology and Knowledge Engineering Conference (TKE 2012)*, pp.258-269. 19-22 June 2012, Madrid, Spain
- (https://www.researchgate.net/publication/235673484_Terminology_Planning_for_the_Croatian_National_Terminology_Database_STRUNA/link/0fcfd512749b519436000000/download.5.05.2023)
- COUNCIL REGULATION (EC) No 1/2003 of 16 December 2002 on the implementation of the rules on competition laid down in Articles 81 and 82 of the Treaty
- Rregullorja e Këshillit (KE) nr. 1/2003 e 16 dhjetorit 2002 mbi zbatimin e rregullave mbi konkurrencën, të përcaktuara në nenet 81 dhe 82 të

- traktatit (tekst kuptimi i të cilit lidhet me ZEE)
- DIRECTIVE 2001/14/EC OF THE EUROPEAN PARLIAMENT AND OF THE COUNCIL of 26 February 2001 on the allocation of railway infrastructure capacity and the levying of charges for the use of railway infrastructure and safety certification
- Direktiva 2001/14/KE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e 26 shkurtit 2001, për ndarjen e kapaciteteve të infrastrukturës hekurudhore dhe caktimin e tarifave për përdorimin e infrastrukturës hekurudhore, dhe certifikimin e sigurisë
- DIRECTIVE (EU) 2016/680 OF THE EUROPEAN PARLIAMENT AND OF THE COUNCIL of 27 April 2016 on the protection of natural persons with regard to the processing of personal data by competent authorities for the purposes of the prevention, investigation, detection or prosecution of criminal offences or the execution of criminal penalties, and on the free movement of such data, and repealing Council Framework Decision 2008/977/JHA
- DIREKTIVA (BE) 2016/680 E PARLAMENTIT EVROPIAN DHE E KËSHILLIT e 27 prillit 2016 për mbrojtjen e personave fizikë në lidhje me përpunimin e të dhënave personale nga autoritetet kompetente me qëllim parandalimin, hetimin, zbulimin, ndjekjen penale të veprave penale apo ekzekutimin e dënimeve penale dhe për lëvizjen e lirë të këtyre të dhënave dhe shfuqizimin e Vendimit Kuadër të Këshillit 2008/977/JHA
- Direktiva 2008/50/KE e Parlamentit Evropian dhe Këshillit e 21 Majit 2008 mbi cilësinë e ajrit dhe për ajër më të pastër për Evropën”
- DIRECTIVE 2008/50/EC OF THE EUROPEAN PARLIAMENT AND OF THE COUNCIL of 21 May 2008 on ambient air quality and cleaner air for Europe
- Direktiva 2008/50/KE e Parlamentit Evropian dhe Këshillit e 21 Majit 2008 mbi cilësinë e ajrit dhe për ajër më të pastër për Evropën.